



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONETE PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrët

Cabinet of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Përcaktimi i procedurës, rasteve dhe afateve të ndërprerjes së punës në institucionet parashkollore

NUMËR: 43/2007

DATË: 9.10. 2007

Në bazë të nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 25 paragrafi 7 i Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, neni 41.5 të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT), nxjerr këtë Udhëzim administrativ (më tutje UA):

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i nxjerrjes së këtij UA është përcaktimi i procedurës, rasteve dhe afateve të ndërprerjes së punës së institucioneve parashkollore.

Neni 2 Rastet e ndërprerjes së punës

MASHT përmes inspektionit të arsimit do ta ndërpres punën e institucionit parashkollor në këto raste:

- a) nëse institucioni edukativo-arsimor është i palicencuar;

- b) nëse rrezikohet jeta e fëmijëve nga gjendja fizike e objektit;
- c) nëse nuk ka ujë të mjaftueshëm, ose uji është i ndotur;
- d) nëse objekti edukativo-arsimor rrezikohet nga zjarri;
- e) nëse objekti edukativo-arsimor rrezikohet nga orteku;
- f) nëse objekti edukativo- arsimor rrezikohet nga vërshimet e ujit;
- g) nëse higjiena dhe nyjet sanitare paraqesin rrezik për shëndetin e fëmijëve dhe punëtorëve;
- h) nëse nuk ka ngrohje gjatë sezonit dimëror;
- i) nëse institucioni edukativo-arsimor dhe aftësues është në shënjestër të grupeve terroriste;
- j) nëse kanoset rreziku nga epidemitë në institucion dhe mjedis;
- k) nëse ndërrohet licenca pa pëlqimin e MASHT-it;
- l) në të gjitha rastet dhe rrethanat që me veprim ose mosveprim paraqitet rreziku për fëmijët;
- m) nëse numri i fëmijëve në grup është më i madh se sa që është përcaktuar në UA, edhe përkundër vërejtjeve paraprake nuk është ndërmarrë asgjë.

Neni 3

Mënyra e ndërprerjes së punës

1. Inspektori i arsimit nëse konstaton se rreziqet nga neni 2 janë evidente për çdo moment, lëshon vendimin e përkohshëm për ndërprerjen e punës dhe ai vendim duhet të zbatohet menjëherë.
2. Pas marrjes së vendimit për ndërprerje të përkohshme të punës, inspektori i arsimit përpilon procesverbalin për gjendjen në institucionin parashkollor dhe në bazë të tij nxjerr vendimin definitiv.
3. Në rast të moszbatimit të vendimit të inspektorit do të shqiptohen sanksionet e parapara në Ligjin për Inspektionin e Arsimit.

Neni 4

Afatet e ndërprerjes së punës

1. Ndërprerja e punës së institucionit parashkollor do të bëhet për aq kohë, për sa do të evitohen pengesat për funksionim normal të institucionit parashkollor .
2. Vendimi duhet të parasheh saktësisht se sa do të zgjasë ndërprerja e punës së institucionit parashkollor, dhe, si e ku do të sistemohen fëmijët e atij institucioni

- parashkollor si dhe shpenzimet e sistemimit të fëmijëve në institucionin tjetër parashkollor.
3. Shpenzimet e sistemimit të fëmijëve në institucionin tjetër parashkollor i bart institucioni parashkollor të cilit i është ndërprerë puna..
 4. Për rifillimin e punës së institucionit parashkollor MASHT do të lëshojë vendim të ri.

Neni 5

Gjobat

Në rast të moszbatimit të vendimit të MASHT-it për ndërprerjen e punës së institucionit parashkollor, ndaj tij do të caktohen gjoba të parapara në Ligjin e Inspektionit të Arsimit, si dhe ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ministri.

Agim Veliu, ministër